



KOLEGJI BIZNESI

AL TRADE CENTER

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. **Kolegji BIZNESI- Prishtinë**, rruga “Motrat Qiriazhi” nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan,

Dhe,
2. **AL TRADE CENTER-Prishtinë**, të cilën e përfaqësonë Sokol Gashani – Drejtor Gjeneral,

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe **AL TRADE CENTER**, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. **AL TRADE CENTER** do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi **Kolegjin Biznesi**, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.

2. **Kolegji Biznesi** do të mbështesë në vazhdimësi **AL TRADE CENTER**, në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit .

3. **Kolegji Biznesi** do të mbështesë **AL TRADE CENTER** me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: emergjencave, ekonomisë dhe juridikut, menaxhimin e shitjes - sipas nevojave që paraqet **AL TRADE CENTER** me deget e saja në Kosovë.



Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

2. Afati i këtij memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi
D e k a n

AL TRADE CENTER

Sokol Gashani
Drejtör Gjeneral

Nënshkruar në Prishtinë, me datë 14 / 12 / 2020